

 Republika e Kosovës - Republika Kosova - Republic of Kosovo AUTORITETI RREGULLATOR PËR SHËRBIMET E UJIT REGULATORY AUTHORITY FOR WATER SERVICES WATER SERVICES REGULATORY AUTHORITY		
Nr. i protokollit: 676 Nr. i dërgimit: D.1.1 Nr. i dërgimit: 30.12.2016 Data: 30.12.2016	ARR/UTSH-09/05/2017 30. 12. 2016	

Në pajtim me autoritetin e dhënë me nenin 19., paragrafi 1 të Ligjit Nr. 05/L-042, për Rregullimin e Shërbimeve të Ujit, të shpallur në Gazetën Zyrtare Nr. 4/2016, datë 14. 01. 2016 ("Ligji").

Konform Nenit 15. Aprovimi i tarifave të shërbimit, të Rregullores ARR/UTSH Nr. 07/2016 për Përcaktimin e tarifave të shërbimit të ujit në Kosovë, datë 23 Shtatori 2016.

Duke u bazuar në të dhënat e aplikacionit për Tarifa Shërbimi të dorëzuara nga KRU "Radoniqi" Sh. A. Gjakovë për procesin tarifarë 2015-2017 dhe analizës së të dhënave të realizuara të performancës së saj, gjatë 9 muajve të parë të vitit 2016, lëvizjeve inflatore të periudhës Dhjetor 2015 – Nëntor 2016, rrethanave socio ekonomike në vend dhe implementimin e paragrafëve 1 dhe 2 të nenit 30. Lidhjet e pa autorizuar të Ligjit Nr. 05/L-042.

Autoriteti rregullator për shërbimet e ujit (ARRU) lëshon këtë:

URDHËRESË PËR TARIFA SHËRBIMI

PËRCAKTIMI I TARIFAVE TË SHËRBIMIT TË UJËSJELLËSIT DHE KANALIZIMIT PËR APLIKIM NGA KRU "RADONIQI" Sh. A. GJAKOVË, GJATË PERIUDHËS TARIFORE 01. 01 – 31. 12. 2017 NGA PROCESI TARIFOR 2015-2017

1. Interpretimi

Në këtë Urdhëresë të Tarifave të Shërbimit (UTSH), përveç nëse konteksti e kërkon ndryshe, fjalët dhe shprehjet me shkronja të mëdha do të kenë kuptimin që u atribuohen Rregullës 07/2016.

2. Zbatueshmëria

Kjo Urdhëresë e Tarifave të Shërbimit është e zbatueshme dhe e detyrueshme për KRU "RADONIQI" sh. a., me rastin e faturimit të Shërbimeve të Ujësijellës dhe Kanalizimit që u ofron konsumatorëve të vet në tërë zonën e saj të shërbimit.

ARRU mund t'i bëjë korrigjimet e jashtëzakonshme të tarifave të shërbimit në bazë të kërkesës së KRU "Radoniqi" sh. a., në pajtim me nenin 16 dhe 17 të Rregullës 07/2016.

3. Përmbytja e shtojcave të UTSH-së

Kësaj Urdhërese Tarifore të Shërbimit i janë bashkangjitur;

3.1 Shtojca Nr. 1 e cila përmban:

- Pika 1. Lista e Tarifave të Shërbimit të aplikueshme për vitin 2017 nën pika 3.2. sqarimet përkatëse,*
- Pika 2. Tarifat për shpenzimet e kyçjes në rrjetin e shërbimeve të ujit*
- Pika 3. Tarifat për shërbimet tjera*

3.2 Shtojca Nr.2. Caqet operative, financiare dhe ato të investimeve kapitale të aprovuara në mes të KRU "Radoniqi" sh.a Gjakovë – ARRU për vitin 2017.

Tarifat e përcaktuara në këtë UTSH janë pa TVSH.

4. Afati

Tarifat e përcaktuara me këtë Urdhëresë të Tarifave të Shërbimit do të jenë të zbatueshme nga: 1 Janari 2017 gjer me 31 Dhjetor 2017.

5. Publikimi dhe Shpërndarja e Listës së Tarifave të Shërbimit

- 5.1 KRU "Radoniqi" sh. a. duhet të shpërndajë Listën e Tarifave të Shërbimit të aprovuara me këtë Urdhëresë të Tarifave të Shërbimit, tek secili Konsumator në momentin e nënshkrimit të Kontratës për Shërbime ose së paku një herë në fillim të aplikimit të saj t'i bashkëngjis të njëjtën faturës me të cilën faturohen konsumatorët.
- 5.2 Lista e Tarifave për Shërbime e aprovuar nga ARRU nën këtë Urdhëresë të Tarifave të Shërbimit duhet të publikohet nga KRU "Radoniqi" sh. a., së paku në njërën prej gazetave ditore me tirazh gjithë përfshirës në tërë Kosovën, brenda shtatë (7) Ditëve të Punës, pas shpalljes dhe publikimit të saj nga ARRU në portalin e internetit të vet; [www. arru-rks.org](http://www.arru-rks.org).

6. Apelet

KRU "Radoniqi" sh. a. ka të drejtë të apelojë këtë urdhëresë ose pjesë të saja brenda një muaj, nga data e publikimit, tek Komisioni Shqyrtues i themeluar konform nenit 41, Komisioni Shqyrtues, Ligji Nr. 05/L-042 për Rregullimin e Shërbimeve të Ujit, të shpallur në Gazetën Zyrtare Nr. 4/2016.

7. Gjuhët Zyrtare të Urdhëresës për Tarifa Shërbimi

Kjo Urdhëresë për Tarifa të Shërbimit publikohet në tri (3) gjuhë, dy nga të cilat janë zyrtare që përdoren në Kosovë dhe në Gjuhën Angleze.

Në rast mospërputhje në mes të versioneve të UTSH-ës, do të mbizotërojë versioni i shkruar në gjuhën Shqipe.



Raif Preteni
Drejtor i ARRU

SHTOJCA 1: LISTA E TARIFAVE TË SHËRBIMIT

1. Tarifat Fikse dhe Tarifat Volumetrike për Shërbimet e Ujësllësit dhe Kanalizimit

Afati i Aplikueshmërisë: 1 Janar 2015 – 31 Dhjetor 2017

Kategoria e Konsumatorëve	Tarifa Fikse (EURO/muaj)	Tarifa Volumetrike për Shërbime të Ujësllësit (EURO/m ³)	Tarifa Volumetrike për Shërbime të Kanalizimit (EURO/m ³)
1. TARIFAT PA INFLACION TË PËRCAKTUARA PËR VITIN 2015 (1 JANAR 2015 – 31 DHJETOR 2015)			
Shtëpiak	1.0	0.3513	0.0883
Institucional dhe Industrial/Komercial	3.0	0.7025	0.2207
1.1 TARIFAT E APLIKUESHME PËR VITIN KALENDARIK 2015 TË PËRCAKTUARA MBI BAZËN E INDEKSIT TË PROJEKSIONEVE TË ÇMIMEVE TË KONSUMIT TË PUBLIKUARA NGA FMN PËR VITIN 2014 Të aplikueshme nga (1 JANAR 2015 – 31 DHJETOR 2015)			
Shtëpiak	1.0	0.36	0.09
Institucional dhe Industrial/Komercial	3.0	0.71	0.22
2. TARIFA PA INFLACION TË PËRCAKTUARA PËR VITIN KALENDARIK 2016 (01.01. 31.12. 2016)			
Shtëpiak	1.0	0.3455	0.0869
Institucional dhe Industrial/Komercial	3.0	0.6910	0.2173
2.1 TARIFAT E APLIKUESHME PËR VITIN KALENDARIK 2016 MBI BAZËN E VLERESIMIT TË PERFORMANCES SE 11 MUJORIT TË PARË TË VITIT 2015, INDEKSIT TË ÇMIMEVE TË KONSUMIT TË PUBLIKUARA NGA ASK, RRETHANAVE SOCIO-EKONOMIKE NË VEND PËR PERIUDHËN 01. 06. – 31. 12 2016			
Shtëpiak	1.0	0.36	0.09
Institucional dhe Industrial/Komercial	3.0	0.71	0.22
3. TARIFAT E APLIKUESHME PËR VITIN KALENDARIK 2017 MBI BAZËN E VLERESIMIT TË PERFORMANCES, INDEKSIT TË ÇMIMEVE TË KONSUMIT TË PUBLIKUARA NGA ASK, RRETHANAVE SOCIO-EKONOMIKE NË VEND PËR PERIUDHËN 01. 01. – 31. 12 2017			
Shtëpiak	1.0	0.36	0.09
Institucional dhe Industrial/Komercial	3.0	0.71	0.22

Sqarim:

- Tarifat e vitit 2017 janë përcaktuar në bazë të procedurave rregullatore të aprovuara nga ARRU, sipas procesit rregullator të tarifave të periudhës tre vjeçare 2015-2017.
- Tarifat e aplikueshme për konsumatorë për vitin 2017 pika 3 janë përcaktuar në bazë të analizave dhe vlerësimit të performancës së kompanisë për 9 mujorin e parë të vitit 2016, lëvizjes së Indeksit të Çmimeve të Konsumit në Kosovë të publikuara nga ASK për periudhën (Dhjetor/2015 – Nëntor/2016) dhe rrethanave socio-ekonomike në vend.
- Tarifat fikse nuk i nënshtrohet rregullimit për inflacion gjatë këtij procesi rregullator të tarifave.

ASK – Agjencia e Statistikave të Kosovës

IÇK – Indeksi i Çmimeve të Konsumit

FMN – Fondi Monetar Ndërkombëtar

2. Tarifat për shpenzimet e kycje në rrjetin e shërbimeve të ujit

Afati i Aplikueshmërisë: 1 Janar 2017 – 31 Dhjetor 2017

2.1. Tarifa Administrative për Kycje në Shërbime*	Diametri i gypit të kycjes/ujëmatësi	Tarifa për kycje në shërbimet e ujësjellësit dhe kanalizimit (EURO)
Për të gjitha Kategoritë e Konsumatorëve (*) –Tarifa për administrim është e pakthyeshme dhe nënkuptojmë të drejtën e konsumatorit për tu kyç në rrjetin e shërbimeve të ujit dhe mbajtjen e tij në regjistrin e konsumatorëve aktiv për çështje të ndryshme administrative. Shumat e inkasuara për këtë destinim përdoren për zgjerimin e rrjetës së shërbimeve të ujit.	(13 – 25) mm	5.00
	32 mm	
	40 mm	
	50 mm	
	65 mm	
	80 mm	
	100 mm	
	150 mm	
2.2. Shpenzimet e Kycjes në Shërbime të Ujësijellësit*	Diametri i gypit të kycjes/ujëmatësit	Shuma (EURO)
Për të gjitha Kategoritë e Konsumatorëve (*) - Shpenzimet e Kycjes në Shërbime përfshijnë shpenzimet e punës dhe materialit në vijim: qafore, pajisjet për kycje, gypat e kycjes në gjatësi deri 15 metra, ujëmatësi me dy valvula,transporti etj. Punët tokësore dhe ato të betonit nuk janë të përfshira.	(13 – 20) mm	120.00
	(25 – 32) mm	160.00
	(40 – 50) mm	220.00
	> 50mm	Do të llogaritet në bazë të çmimeve për material dhe punën.
	-	
2.3. Shpenzimet e Kycjes në Shërbimet e Kanalizimit *	Diametri i gypit të kycjes	Shuma (EURO)
Për të gjitha Kategoritë e Konsumatorëve (*) – Shpenzimet e Kycjes në Shërbime përfshijnë shpenzimin e punës dhe të materialit në vijim: elementet fazonike për kycje dhe gypit në gjatësi deri 15 metra. Punët tokësore dhe ato të betonit nuk janë të përfshira.	DN 110 mm	100.00
	DN 160 mm	120.00
	DN 200 mm	160.00
	> 200 mm	Do të llogaritet në bazë të çmimeve për material dhe punën.

2. Tarifat për Shërbimet Tjera

Afati i Aplikueshmërisë: 1 Janar 2017 – 31 Dhjetor 2017

Lloji i Shërbimit	Shuma (EURO)
3.1. Dërgimi i njoftimit për ndërprerje i faturohet vetëm njëherë konsumatorit dhe atë pas dërgimit të njoftimit të dytë brenda vitit kalendarik, sipas Ligjit Nr.05/L-042, Neni 28 dhe 29, si dhe Rregullores së ARRU-së Nr.03/2016, neni 30	3.00
3.2. Shkyçja e Shërbimeve të Ujësjetës	20.00
3.3. Rikyçja e Shërbimeve të Ujësjetës	20.00
3.4. Riparimi i rrjedhjeve në objektin e Konsumatorit	Duhet të llogaritet në bazë të çmimeve për material dhe punën
3.5. Shitja e ujit me cisterna të ujit – transporti deri në 5 km	20.00 EURO/5m3
3.6. Riparimi i ujëmatësit nga çmimi i ujëmatësit kur kompania e instalon ujëmatësit e saj	Max. 60% të çmimit të ujëmatësit
3.7. Kontrollimi i ujëmatësit – verifikimi i saktësisë	15.00

SHTOJCA 2:**CAQET OPERATIVE, FINANCIARE DHE ATO TË INVESTIMEVE KAPITALE TË APROVUARA NË MES TË KRU "RADONIQI" SH.A GJAKOVË – ARRU PËR VITIN 2017**

Këto caqe paraqesin obligim kontraktual ndërmjet KRU-së dhe ARRU për t'u përmbush gjatë vitit kalendarik biznesor 2017 me përshtatjet e bëra për lëvizjet inflatore të periudhës së caktuar.

Caqet e aprovuara ndërmjet ARRU dhe KRU	Njësia	Viti 2017
Të dhënat operative		
1.1 Uji i prodhuar	m ³ /vit	15,053,502
1.2 Uji i humbur	m ³ /vit	6,924,610
1.3 Uji i faturuar	m ³ /vit	8,128,892
1.4 Numri i konsumatorëve	Nr	36,804
Të dhënat financiare		
2. Shuma vjetore e shpenzimeve operative	€/vit	2,876,056
2.1 Pagat bruto	€/vit	2,213,556
2.2 Mirëmbajtja dhe riparimet	€/vit	78,000
2.3 Energjia Elektrike	€/vit	256,000
2.4 Derivatet	€/vit	68,100
2.5 Kemikalet	€/vit	20,400
2.6 Shpenzimet tjera	€/vit	240,000
3. Faturimi	€/vit	4,251,469
3.1 Amvisëri	€/vit	3,377,636
3.2 Biznese	€/vit	599,264
3.3 Institucione	€/vit	274,569
4. Arkëtimi	€/vit	3,413,009
4.1 Amvisëri	€/vit	2,634,556
4.2 Biznese	€/vit	509,375
4.3 Institucione	€/vit	269,078
5. Shkalla e arkëtimit total	€/vit	80%
5.1 Amvisëri	€/vit	78%
5.2 Biznese	€/vit	94%
5.3 Institucione	€/vit	98%
Të dhënat e investimeve kapitale		
6. Investimet kapitale vetanake	€/vit	536,953
6.1 Investimet kapitale për shërbimet e ujit	€/vit	486,953
6.2 Investimet kapitale për shërbimet e kanalizimit	€/vit	50,000
7. Investimet kapitale nga donacionet	€/vit	12,780,000
7.1 Investimet kapitale për shërbimet e ujit	€/vit	7,780,000
7.2 Investimet kapitale për shërbimet e kanalizimit	€/vit	5,000,000

ARRU edhe gjatë këtij viti do të monitorojë të dhënat e arritura për treguesit kryesor nga kompania për të vlerësuar shkallën e përmbushjes së objektivave të përcaktuara të cilat do të publikohen përmes tri raporteve periodike, 6, 9 dhe 11 muajve të parë të vitit 2016 dhe atë vjetor pas përmbylljes së vitit biznesor 2017.

Prishtinë, 30.12.2016
DFTRR/ARRU